



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 380, datë 02.10.2020

PËR
KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË
NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR TRE POZICIONET E LIRA
NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE DHE CIVILE, TË SHPALLURA ME
VENDIMET NR. 82, NR. 83 DHE NR. 85, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja e saj, znj. Marçela Shehu,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85, datë 26.02.2020.
2. Vendimi nr. 234, datë 02.07.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR